

Ç'KËRKONIM PREJ AMBASADORIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

Z. HELMUTH LOHAN

Me rastin e largimit të ambasadorit të BE zotit Helmuth Lohan, do të dëshironim nga institucionet drejtuese të Bashkimit Europian, që ambasadori i ri që do të emërohet në Shqipëri të mos heshti ndaj shkeljes së të drejtës së pronës private dhe transferimit të paligjshëm të saj sipas interesave klanore të pushtetarëve. Përfaqësuesi i BE me kohë duhet të kishte vënë në dukje se Qeverisë nuk i lejohet të shkeli nenin 181 të Kushtetutës. Këtë nen dhe parim të së drejtës, populli e ka zbatuar me kohë në gjithë zonat verilindore dhe tani në Qarkun e Vlorës, ku anarkia e pronës është më e theksuar, parimin dhe drejtësinë po e vendos dhe po e zbaton vetë populli i Dukatit. Qeveria duhet të reflektojë: Secili në pronat e tij të trashëguara, kjo është çrrënjësja e komunizmit dhe fillimi i demokracisë.

Personilisht ardhja e z. Helmuth Lohan në 2006 si ambasador i BE, më gëzoi për faktin se ishte gjerman dhe nga eksperiencia e jetës së tij me vendin e tij të ndarë në dy sistemet, ai e dinte shumë mirë se çështje në thelb sëmundja e komunizmit, si çrrënjëset komunizmi dhe rrezikun e korupsionit postkomunist. Në 2006 u gëzuam edhe për faktin se zoti Lohan veç karrieres diplomatike kishte formim ekonomisti, por unë dhe të gjithë pronarët e shpronësuar mbetëm thellësisht të diziluzionuar. Demokracia në Shqipëri ka humbur 4 vjet nga heshtja e z. Helmuth Lohan ndaj anarkisë së pronave. Ky mentalitet i tij ndofta është rezultat i influencave komuniste gjatë shkollimit në Pragë në vitet 1975 apo më vonë gjatë karrierës diplomatike si konsull në Moskë, pa përjashtuar detyrime të tjera të tij.

Është fakt se ambasadorit Lohan nuk i mungonte informacioni për anarkinë e pronës dhe për standardin e dyfishtë që është zbatuar me kthimin e pronave pas vitit 1991. Zoti Lohan nuk u shpreh asnjëherë se pa kthyer pronën tek i zoti, pa respektuar të drejtën e pronësisë, nuk mund të ketë qetësi sociale dhe as stabilitet ekonomik dhe as antarësim në BE. Ai e dinte shumë mirë se antarësimi i Shqipërisë në BE do të mbetet vetëm mundësi teorike por jo praktike pa kthyer fizikisht pronën tek i zoti. Megjithatë, kur erdhi puna që z. Lohan të thonte mendimin e tij, ai u shpreh se zgjidhja bëhet me kompensim të pronarëve dhe jo me kthimin fizik të pronës tek i zoti, që do të thotë se ata që kanë grabitur dhe përfituar padrejtësisht duhet të quhen pronarë !!. Kështu jo vetëm që nuk respektohet pikat e Deklaratës së Kopenhagenit dhe të Konventës së të Drejtave të Njeriut,

por servilizëm më të madh ndaj politikës antipronar të kryeministrit Sali Berisha nuk ka. Si mund të shpjegohet fakti se misiōni ‘Euralius’ në ciklin 4 vjeçar, qëndroi i heshtur para argumentave të Shoqatës tonë ndaj situatës antiligjore dhe antikushtetuese ku ligjet për pronat bien ndesh me nenin 181 të kushtatutës dhe me të drejtën e pronës. Pushtetarët tanë, të pas 1991 megjithse e akuzojnë njëri tjetrin nëpër ekrane, por ata pëlqejnë tranzicionin dhe korrupsionin dhe bëjnë çmos që Shqipëria të mos futet në BE, pasi me hyrjen në BE ata do të humbisnin gjithë sa kanë përfituar dhe akumuluar në këtë periudhë të tranzicionit dhe anarkisë postkomuniste. Ne kemi sensibilizuar edhe më parë për faktin se institucionet ndërkombëtare informohen në mënyrë të njëanëshme dhe të turbullt për situatën dhe problemet më shqetësuese në Shqipëri, ku problemi i mos kthimit të pronës tek i zoti minimizohet. Nuk dimë nëse institucionet ndërkombëtare mashtrohen qëllimisht në mënyrë sistematike apo ka përfshirje aktive. Mos vallë këta ambasadorë nuk e kuptojnë se pa respektuar të drejtën e pronës pranimi në BE mbetet vetëm mundësi teorike? Mos vallë kjo klimë korrupsioni i mban ngrohtë dhe i bën për vete edhe ambasadorët ?

Ndërkohë që pronarët mbahen peng në procesin e kthimit fizik të pronave dhe kryeministri Berisha bën veshin e shurdhër ndaj ankesave të shoqatës së pronarëve, mediat kanë informuar se në rreth 700 prona në bregdet janë blerë nga serbët, po ashtu Qeveria Berisha nxitohet për të bërë shitje, privatizime dhe legalizimet e pushtimeve dhe ndërtimeve pa leje. Si mundet Qeveria të sheshi toka e prona pa përfunduar më parë kthimi fizik të pronave tek të shpronësuarit. Nga ana tjetër çdo ditë raportohen milionat e fituara nga politikanët, ku PD dhe PS, denoncojnë reciprokisht njëri tjetrin. Prej gati 20 vjetësh, kjo politikë klanesh tëpa përgjegjshëm, që shkel parimin bazë të së drejtës, ka krijuar këtë situatë të rëndë. Shqiptarët po pushtojnë pronat e njëri tjetrit dhe po vriten ndërmjet tyre ndërkohë që deputetët pasurohen, prokuroria hesht. E çfarë vlere ka kur pensioni shtohet më pak se niveli i inflacionit dhe pavarësisht se një pension shtohet pak euro në muaj, njerëzit varfërohen realisht gjithnjë e më shumë ?

Kush mundet ta shpjegojë faktin se prej 19 vjetësh politikanët, duke zbatuar ligjin antikombëtar 7501 shkelin të drejtën e pronësisë që është zbatimi i platformës së presidentit komunist Ramiz Alia sipas udhëzimeve të Katovicës, dhe të gjithë heshtin. Në shkrimin me titull ” mos qëndroni të verbër dhe të heshtur para realitetit që po e shkatërron shqipërinë” publikuar me datë 23 Korik 2010, drejtuar ambasadorëve dhe politikanëve kemi shtruar pyetjen nëse heshtja ndaj anarkisë së pronës dhe shkeljes së detyrimeve kushtetuese lidhet me agjentë, influenza agjenturore, me pagesa korruptive apo çfarë ?

Nëse PD dhe PS nuk janë klane dhe kupola që mashtrojnë dhe korruptojnë, por janë formacione politike Sali Berisha dhe Edi Rama duhet të reagojnë siç reagan të gjitha qeveritë dhe politikanët postomuniste të vendeve të ish kampit socialist që pas 1990 ndryshuan sistemin. Për sa kohë Kuvendi dhe Qeveria Berisha nuk ju jep shqiptarëve ligjin që tu kthejë fizikisht pronat e tyre të trashëguara, që ja grabiti diktatura, Shqipëria po ndryshon në drejtim të prishjes së identitetit ; ajo po transformohet në një shprehje gjeografike, që po shitetet dhe do të vazhdojë të shkatërohet pjesë pjesë për të plotësuar interesat e klaneve. Vetëm një Ligji i ri që korigjon gabimet e derisotme dhe kthen pronat tek i zoti dhe korigjon korrupsionin 19 vjeçar të pushtetarëve me pronat, është pasaporta e vërtetë që hap dyert për në demokraci dhe Evropë. Për këtë arsye kemi kritikuar dhe vazhdojmë ta kritikojmë Qeverinë dhe Kryeministrin Berisha, se pas vitit 1991 politikanët shqiptarë, po e trajtojnë pronën e konfiskuar nga komunizmi si pasuri në interes të klaneve të politikës, sllavokomuniste dhe po i shërbejnë interesave antikombëtare. Si kryetari i PD z. Sali Berisha dhe kryetari i PS z. Edi Rama heshtin. A është kjo heshtje shenjë e demokracisë ?

Që demokracia në Shqipëri të fillojë të marrë drejtimin Euro-atlantik, dëshirojmë që ambasadori i ri i BE që do të emërohet në Shqipëri, të jetë i formuar dhe mos heshti ndaj shkeljes së drejtës së pronës private dhe transferimit të paligjshëm të pronave sipas interesave klanore të pushtetarëve. Përsërim edhe një herë apelin tonë ndaj kancelarive të vendeve demokratike dhe institucioneve ndërkombëtare demokratike ndaj mediave si pushtet i katërt dhe ndaj shoqërisë civile: Sa jetë njerëzish më shumë do të duhet të vyshken për shkak të abuzimit kriminal të pronave, sa dekada më shumë abuzimi kriminal me pronen do te duhet te kalojnë, sa herë më shumë do të duhet të pasurohen abuzivisht klasa politike dhe ata që janë mbrapa tyre dhe sa herë më shumë do të duhet të rrenohet shtesa e pronareve të vërtetë e të ndershëm, esnafëve, intelektualëve, patriotëve, etj., sa më i gjatë do të duhet të jetë vargu i gjeneratave të shitblerjeve abuzive, ilegale dhe antikonstitucionale te pronave, sa më i larte do te duhet të jetë niveli i korrupsionit të ekzekutivit, gjyqesorit dhe legjislativit për shkak të abuzimeve me pronën, sa më thellë do të duhet të futen në konflikt social shqiptarët me njeri tjetrin për shkak të pronës që ju të ndërhyri duke thënë fjalen tuaj për këtë çështje kaq parimore, kaq vitale për një komb dhe shtet?

Me respekt,

Rrapo Hajredin Danushi, Kryetar

Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve "Pronësi me Drejtësi"